

AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GRAVITON” shpk

Sot, më 22/04/2024, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtme:

FATOS HOXHA, atësia Smajl, shtetas zviceran, identifikuar me anë të pasaportës me numër X6824484 i datëlindjes 04/12/1975, lindur në Shkodër, Shqipëri dhe banues në Kilchberg, Zvicër; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

BLERINA KODRA, atësia Qeramedin, shtetase shqiptare, identifikuar me anë të numrit personal të identifikimit H45317147V, e datëlindjes 17/03/1974, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë; madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 1
Themelimi

- 1) Emri i shoqërisë është **“GRAVITON” shpk**.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 2:
Objekti

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Tregtimi i aparaturave e materialeve mjekësore: Tregtim me shumicë dhe pakicë i aparaturave mjekësore, dentare, industriale, ambientale, diagnostifikimi, aksesorë laborator, kite dhe reagentë laboratorikë, mjekësor dhe dentar.

Tregtim i pajisjeve laboratorike: Tregtim me shumicë dhe pakicë i pajisjeve laboratorike dhe industriale, aksesorë laborator, produkte të ndryshme në funksion të shërbimeve laboratorike, pjesëve laboratorike, dhe produkte të ngjashme.

Tregtim i pajisjeve dhe makineri industriale dhe farmaceutike: Tregtim me shumicë dhe pakicë i pajisjeve industriale dhe lëndëve të para, makineri për prodhimin dhe ambalazhimin e produkteve industriale dhe ushqimore, medikamenteve, produkteve dentare dhe veterinare.

Tregtimi i medikamenteve të ndryshme: Tregtim me shumicë dhe pakicë i të gjitha llojeve të barnave, ilaçeve, produkteve farmaceutike, kozmetike, dentare, veterinare si edhe përpunim, fraksionimi dhe ambalazhimi i tyre.

Importimi dhe eksportimi i lëndëve të para ose të përpunuara te: materialeve mjekësore dhe stomatologjike, barnave, medikamenteve, ilaçeve, produkteve ushqimore, ambalazheve, materialeve të tjera ndihmëse, dhe të gjitha ilaçet, apo materiale të tjera të ngjashme.

Neni 3:
Kohëzgjatja

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 4:
Selia

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rr. e Barrikadave, Galeria e Tiranës, Nr.50, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 5
Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 12,000 (dymbëdhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a) Ortaku themelues Fatos Hoxha, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 6,000 (gjashtëmijë) Lekë, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b) Ortaku themelues Blerina Kodra, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 6,000 (gjashtëmijë) Lekë, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6
Administratori

- 1) Administratori i shoqërisë zgjidhet Glauk Lamani, atësia Ledio, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të numërit personal të identifikimit K10727057F i datëlindjes 27/07/2001, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë; me afat 5 vjet.

Neni 7
Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8
Mosmarrëveshjet


- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

ORTAKËT
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GRAVITON” shpk

FATOS HOXHA

Fatos Hoxha

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)



BLERINA KODRA

Blerina Kodra

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

